

VENDIM

Nr. 816, datë 26.11.2014

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN

NR. 628, DATË 29.9.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E MEDALJEVE QË DO TË JEPEN ME RASTIN E 70-VJETORIT TË ÇLIRIMIT TË VENDIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në vijim të vendimit nr. 541, datë 7.8.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2014, miratuar për disa institucione, për festimet e 70-Vjetorit të Çlirimit të Vendit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes dhe ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 4, të vendimit nr. 628, datë 29.9.2014, të Këshillit të Ministrave, shtohet një fjali, me këtë përmbajtje:

“Personelit, që do të marrë këtë medalje, do t’i jepet një shpërblim prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh për secilin.”.

2. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes dhe ministri i Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama